



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 67 datë 01.07 2026

PËR EMERTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PËRMET.

ME EMRIN: BABA HEKURAN NIKOLLARI (PAS VDEKJES)

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b" nënpika 1.7 shkronja "b" neni 54 shkronja II" dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, , veçanërisht dispozitat që përcaktojnë kompetencat e këshillit bashkiak për administrimin e çështjeve me interes vendor dhe emërtimin e hapësirave publike; neni 3 të ligjit 9270 datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, kërkesa e Komunitetit Bektashi në Përmet përfaqësuar nga Sekretari i Teqeve, z.Fatjon Skënderi, mbi bazën e relacionit të paraqitur si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Përmet,

V E N D O S I:

1. Miratimin e emërimit me emrin **BABA HEKURAN NIKOLLARI** (pas vdekjes) të segmentit rrugor në qytetin e Përmetit, me gjatësi 220 ml, Sipas fragmentit të hartës së paraqitur bashkëlidhur këtij Vendimi si më poshtë: *Segmenti nga kryqëzimi i ish degës ushtarake deri tek ish stacioni i vjetër i zjarrfikses.Me kordinata sipas KRGJSH, pika e fillimit: E 530347.34 N 4455255.34, pika e mbarimit E 530174.72 N 4455099.00.*
2. Çdo Vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorja e Ekonomise Zhvillimit Buqësisë e Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet

Agim ANDONI

